

V E N D I M
Nr.474, datë 29.7. 1998

**PËR DOKUMENTACIONIN QË EVIDENTON DHE SHOQËRON MJETET E
TRANSPORTIT TË MALLRAVE NË LËVIZJE**

Mbështetur në nenin 39 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lëvizja e mallrave, me çdo mjet transporti rrugor, për të tretë me qira ose për nevojat e veta do të bëhet i shoqëruar detyrimisht me fletëngarkesë (police ngarkesë), me të dhënat kryesore, sipas lidhjes I.

2. Transportuesi mban fletudhëtimin për çdo mjet transporti në lëvizje, duke regjistruar të dhënat në çdo kohë sipas përmbajtjes së përcaktuar në lidhjen II.

3. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit miraton tipin e formularëve dhe çdo ndryshim të lidhjeve I dhe II.

4. Në rastin e transportit të mallrave, për të cilat sipas dispozitave ligjore zbatohen rregulla dhe dokumente të posaçme, përveç dokumentacionit të treguar më sipër, transportuesi është i detyruar të pajiset edhe me dokumentet përkatëse shtesë.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit që, nëpërmjet ndërmarrjes së shërbimeve të transportit, të sigurojë shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit bazë për transportuesit.

6. Ngarkohet ndërmarrja e shërbimeve të transportit për zbatimin e kritereve të këtij vendimi, në lidhje me kontrollin e dokumentacionit që mbajnë transportuesit për transportin e mallrave.

7. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që janë të pajisur me leje për kryerjen e transportit të mallrave, detyrohen të zbatojnë, në procesin e transportit, dokumentacionin që përcaktohet në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me datën 1 tetor 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.I

Të dhënat që përmban fletë (police) ngarkesa:

A. Për transportin brenda vendit.

1. Të dhënat për numrin dhe datën e fletë (police) ngarkesës
2. Të dhënat për transportuesin (emrin e shoqërisë së transportit ose subjektit transportues).

3. Të dhënat për mjetin që transporton mallin (marka dhe tipi, kapaciteti transportues dhe targa).

4. Numrin e fletës së udhëtimit të transportuesit.

5. Të dhëna për drejtuesin e mjetit (emri, mbiemri).

6. Të dhëna për vendin e ngarkimit e datën e ngarkimit dhe vendin e shkarkimit e datën e shkarkimit të mallrave.

7. Të dhëna për llojin e mallit që do të transportohet dhe peshën e mallit të ngarkuar gjithsej dhe të ndarë më vete për kamionin dhe më vete për rimorkion.

8. Të dhëna për vleftën e përgjithshme të transportit të mallit të ngarkuar në mjet (për destinacionin e mallit) nga nisësi deri tek pritësi i mallit ku të përmbajë sasinë në ton dhe vëllimin në ton-km; tarifat lekë/ton ose tarifat lekë/ton-km; vleftën e transportit ose çmimin e përgjithshëm të transportit dhe TVSH-në.

9. Nënshkrimin e dërguesit, pritësit dhe transportuesit të mallit të ngarkuar.

Shënim:

a) Të dhënat e pikave 1 deri tek 7 plotësohen nga dërguesi i mallit.

B) Për transport ndërkombëtar

Të dhënat e fletë (police) ngarkesës do të jenë në përputhje me rregullat e konventave ose të organizatave ndërkombëtare të transportit rrugor që ka aderuar Republika e Shqipërisë.

LIDHJA NR.II

Të dhënat që përmban fleta e udhëtimit:

1. Emërtimin e transportuesit shoqëri transporti (person juridik) ose subjekt transporti (person fizik).

2. Numrin e licencës ose lejes, si edhe kohën e lëshimit të saj, mbi bazën e të cilit transportuesi ushtron veprimtarinë e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta.

3. Numrin e fletudhëtimit të vënë në përdorim.

4. Tipin e mjetit të përdorur, targa e regjistrimit.

5. Emrin dhe mbiemrin e drejtuesit të mjetit të përdorur.

6. Gjendjen e karburantit dhe furnizimin e mundshëm.

7. Llojet e mallrave që do të transportohen dhe sasia në ton.

8. Numrin e fletë (police) ngarkesës, si dhe destinacionin e mallit të specifikuar me vendndodhje dhe me vendmbërritje.

9. Kilometrat e përshkruara gjatë transportimit të mallrave deri në destinacionin e tij dhe kthimin deri në vendndodhje të transportuesit. Kilometrat gjithsej të jenë të ndara në kilometra me ngarkesë dhe kilometra pa ngarkesë.

10. Vëllimin e punës së kryer në ton-km.

11. Kohën e punës së drejtuesit të mjetit, ku të përfshihen: koha e paraqitjes në punë të drejtuesit të mjetit, koha e paraqitjes në vendin e destinimit të mallit, koha e fillimit të transportit të mallit, koha e mbarimit të shkarkimit të mallit, si dhe koha e kthimit të drejtuesit të mjetit në vendin e punës, koha e punës në udhëtim (timon) dhe pushimet eventuale gjatë udhëtimit. Të gjitha këto plotësime do të bëhen për rastet kur mjetet nuk janë të pajisura me tahograf.

12. Përmbledhësen e të dhënave të pikave 6,7,9,10, dhe 11 për çdo fletudhëtim.

Shënim:

Plotësohen nga transportuesi të dhënat e pikave nga 1 deri 5, 7 dhe 8 para nisjes së mjetit në udhëtim. Por, nga transportuesi plotësohen, edhe disa kërkesa të pikës 6 për gjendjen e karburantit para nisjes në udhëtim, si edhe disa kërkesa të pikës 11, konkretisht koha e paraqitjes në punë dhe e kthimit në vendin e punës pas mbarimit të udhëtimit të drejtuesit të mjetit. Gjithashtu, edhe të dhënat e pikës 6 që kanë të bëjnë me

furnizimet gjatë udhëtimit, si edhe të pikës 9 plotësohen nga transportues pas kthimit në vendin e punës.

Plotësohen disa të dhëna të pikës 11, nga nisësi i mallit: kohën e paraqitjes së mjetit në vendin e ngarkimit dhe kohën e fillimit e të përfundimit të ngarkimit dhe nga pritësi i mallit, koha e paraqitjes së mjetit në vendin e shkarkimit, kohën e fillimit dhe të përfundimit të shkarkimit të mallit.